

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7885  
E mërkurë, 18 shtator 2024  
Çmimi 0.50 €

I vihet zjarri një shtëpie  
në veri të ndërtuar  
nga qeveria | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI KA TAKUAR TË MARTËN KRYETARIN  
E ZUBIN POTOKUT DHE ATË TË ZVEÇANIT | FAQE 4-5

## KRYETARI I ZUBIN POTOKUT DHE AI I ZVEÇANIT KËRKOJNË PËRKRAHJE NGA QEVERIA PËR INVESTIME NË INFRASTRUKTURË



Kryeministri Kurti ka takuar kryetarin e Zubin Potokut, Izmir Zeqiri dhe atë të Zveçanit, Ilir Peci, me të cilët ka diskutuar për punën, arritjet e deritashme dhe sfidat e trashëguara dhe mundësitë për t'i


trajtuar dhe adresuar ato gjatë pjesës së mbetur të mandatit qeverisës. Ata e kanë njoftuar kryeministrin edhe për mbarëvajtjen e procesit të konvertimit të dokumenteve dhe

pajisjes së qytetarëve me dokumente të Republikës së Kosovës, por edhe për rezultatet e deritanishme të masave të punësimit të mbështetura nga qeveria

KOSOVA DHE GJERMANIA  
DISKUTOJNË PËR ÇËSHTJET  
SOCIALE, SHOETËSUES  
LARGIMI I INFERMIERËVE  
DHE MJEKËVE | F. 7



RAUNDI I RI  
I BISEDIMEVE  
NË BRUKSEL  
PËRFUNDOI PA  
TAKIM TREPALËSH | F. 5



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SPORT



PIRA PASI MORI ÇMIMIN  
'YLLI I JAVËS': SYNOJMË KREUN  
E TABELËS | F. 10

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Von der Leyen zgjedh sllovenen Marta Kos komisionare të Zgjerimit

**BRUKSEL, 17 SHTATOR** - Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, paraqiti të martën përbërjen e re të Komisionit Evropian, e cila do të ketë mandat pesëvjeçar.

Postin e komisionares për zgjerim ajo ka vendosur t'ia japë kandidatës nga Sllovenia, Marta Kos. Por, ajo do të emërohet zyrtarisht vetëm nëse merr mbështetjen e Parlamentit të Sllovenisë dhe të Parlamentit Evropian.

Kos nuk është nominuar formalisht nga vendi i saj. "Çdo anëtar i ekipit tim do të sjellë përvojën dhe perspektivat e veta për Evropën", shkroi von der Leyen në platformën X.

Portofoli i zgjerimit ka rëndësi të veçantë për rajonin e Ballkanit Perëndimor, sepse të gjashtë vendet e tij, plus Ukraina, Moldavia, Gjeorgjia dhe Turqia, janë në proces të zgjerimit.

Me përjashtim të Kosovës, të gjitha janë vende kandidatë, e disa edhe në negociatë për anëtarësim.

Kandidatura e Kosit ka shkaktuar

kundërthënie në Slloveni, pasi opozita nuk dëshiron ta mbështesë e as të caktojë seancë dëgjimore në Komisionin përkatës parlamentar.

Autoritetet sllovene kanë ndërruar në momentin e fundit kandidatin e tyre, për t'i ndihmuar von der Leyenit ta rrisë numrin e grave në Komision, pasi ishte më pak se një e treta. Megjithatë, kërkesa e von der Leyenit u pa nga disa si ndërhyrje në sovranitetin e një vendi anëtar të BE-së.

Kryetari i Komisionit për Çështje Evropiane të Parlamentit të Sllovenisë, Franc Breznik, i cili vjen nga opozita, ka refuzuar ta vendosë në rend dite konfirmimin e Kosit.

Për pasojë, von der Leyen nuk ka mundur ta propozonte Komisionin e ri më 10 shtator, kur ka qenë e planifikuar, por e ka shtyrë për 17 shtator. Ajo e ka bërë tani këtë propozim, me pritjet që edhe Sllovenia ta përfundojë ndërkohë procedurën e saj.

Opozita në Slloveni ka akuzuar Kosin se ka qenë bashkëpunëtorë



e shërbimit sekret komunist të ish-Jugosllavisë.

Kos ka qenë ambasadore e Sllovenisë në Gjermani dhe në Zvicër.

Më herët ka punuar edhe në

Qeverinë e Sllovenisë si drejtoreshë për raportet me mediet. Sipas traktateve të BE-së, secili vend anëtar ka të drejtë të ketë një komisionar. Për rrjedhojë, Komisioni Evropian ka po aq

anëtarë sa ka edhe vende anëtare, përkatësisht 27.

Von der Leyen ka përsëritur disa herë se, gjatë mandatit të ardhshëm 5-vjeçar, do ta ketë prioritet zgjerimin e BE-së.

## Stoltenberg: Vendet të vendosin vetë nëse Ukraina mund t'i përdorë armët me rreze të gjatë në Rusi

**BRUKSEL, 17 SHTATOR** - Shefi në largim i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se i mirëpret bisedimet për përdorimin e raketave me rreze të gjatë veprimi nga Ukraina për sulme brenda Rusisë, por shtoi se çdo vendim për këtë çështje duhet të merret nga secili vend aleat veç e veç.

Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka kohë që u bënë thirrje vendeve të Perëndimit t'i heqin kufizimet ndaj vendit të tij për përdorimin e armëve me rreze të gjatë veprimi për sulme thellë brenda Rusisë.

Kryeministri i Britanisë së Madhe, Keir Starmer, dhe presidenti amerikan, Joe Biden, biseduan në Uashington të premtën nëse duhet të lejohet Kievi t'i përdorë raketat me rreze të gjatë veprimi



kundër shënjestrave brenda Rusisë.

Asnjë njoftim rreth kësaj çështjeje nuk u bë me dije. "Unë i mirëpres

këto zhvillime dhe këto vendime, por u takon aleatëve veç e veç ta marrin vendimin përfundimtar", tha Stoltenberg për LBC radio.

"Politikat e aleatëve për këtë çështje dallojnë", shtoi ai.

Disa zyrtarë amerikanë nuk besojnë se lejimi i përdorimit të

raketave të tilla do ta bëjë ndonjë dallim të madh në luftën e Kievit kundër pushtuesve rusë.

Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, tha javën e kaluar se Perëndimi do të futej në një luftë të drejtpërdrejtë me Rusinë, nëse do ta lejonte Ukrainën të kryejë sulme në tokën ruse me raketa me rreze të gjatë veprimi të prodhuara nga Perëndimi.

I pyetur për mundësinë e hakmarrjes nga Rusia, Stoltenbergu tha se "në luftë nuk ka opsione pa rreziqe". "Por, unë vazhdoj të besoj se rreziku më i madh për ne, për Britaninë, për NATO-n, do të jetë nëse presidenti Putin e fiton luftën në Ukrainë", shtoi ai. Stoltenbergu, ish-kryeministër i Norvegjisë, do të largohet nga drejtimi i NATO-s në tetor të këtij viti.

## Meta ndalon RT-në dhe disa medie të tjera ruse

**MENLO PARK, 17 SHTATOR** - Kompania që zotëron "Facebook"-un, "Meta", tha se do të ndalojë disa medie shtetërore ruse në platformat e saj, përfshirë RT-në dhe "Rossiya Segodnya"-n. Sipas "Meta"-s, këto medie kanë përdorur taktika mashtruese për të kryer operacione të fshehta të ndikimit në internet. Kjo

ndalesë përbën përgjigjen më të ashpër të kompanisë më të madhe në botë të medieve sociale kundër medieve shtetërore ruse.

Deri më tash ajo ka ndërmarrë hapa më të kufizuar, si bllokimi i reklamave të tyre. "Pas shqyrtimit të kujdesshëm ne i kemi zgjeruar masat kundër medieve shtetërore

ruse. 'Rossiya Segodnya', RT dhe entitete të tjera janë tani të ndaluara në aplikacionet tona në të gjithë botën", tha "Meta". Sipas saj, zbatimi i ndalesës do të fillojë gjatë ditëve në vazhdim. Përveç "Facebook"-ut, "Meta" zotëron edhe "Instagram"-in, "WhatsApp"-in dhe "Threads"-in.





# DASH-i përsërit: Dialogu Kosovë - Serbi, e vetmja rrugë përpara

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Departamenti Amerikan i Shtetit përsëriti se e ardhmja e Kosovës dhe e Serbisë është në institucionet e Bashkimit Evropian dhe se dialogu mes tyre, i ndërmjetësuar nga BE-ja, është “e vetmja rrugë përpara”. I kontaktuar nga “Radio Evropa e Lirë” për t’i komentuar kërkesat e presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, për Kosovën, një zëdhënës i Departamentit të Shtetit tha se ShBA-ja “vazhdon ta mbështesë fuqishëm dialogun e lehtësuar nga BE-ja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si rrugë për të arritur një marrëdhënie paqësore dhe produktive ndërmjet dy vendeve”.

Gjatë një adresimi në fund të javës së kaluar, Vuçiqi kërkoi riintegrimin e serbëve në institucionet e Kosovës, përfshirë kthimin e tyre në Drejtorinë Rajonale të Policisë së



Kosovës për veriu, kthimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë në funksionet e tyre dhe mbajtjen e zgjedhjeve lokale në veri të Kosovës. Komunitet në këtë zonë të banuar

me shumicë serbe aktualisht udhëhiqen nga shqiptarë, pasi banorët lokalë i bojkotuan zgjedhjet. Kryetarët serbë, ashtu si edhe zyrtarët tjerë të komunitetit në

verim dhanë dorëheqje nga institucionet e Kosovës në nëntor të vitit 2022, kur tensionet ishin të larta për shkak të vendimit të autoriteteve të Kosovës për t’i zëvendësuar

targat serbe të makinave me targa të Kosovës.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, nuk i komentoi kërkesat e Vuçiqit, por kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, i cili vjen nga partia e Kurtit, tha se ato janë antikushitetuese.

Zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit u bëri thirrje Kosovës dhe Serbisë “të përmbahen nga retorika e mëtejshme përshkallëzuese, veprimet e pakoordinuara apo aktet legjislative që bien ndesh me normalizimin e marrëdhënieve të tyre ose që rrezikojnë stabilitetin dhe sigurinë”.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka theksuar një ditë më parë se ky proces tashmë ka vdekur. “Unë kam thënë se me këtë strukturë dialogu tashmë ka vdekur. Të shohim çfarë po ndodh në vitin 2025”, ka thënë ai.

## I vihet zjarri një shtëpie në veri të ndërtuar nga qeveria

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Një shtëpie në lagjen Kroi i Vitakut në Mitrovicën e Veriut, zonë e banuar me shumicë serbe, iu vu zjarri në orët e para të së martës, ka bërë me dije ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi.

Lajmin e ka konfirmuar edhe zëvendës drejtori i Policisë së Kosovës për veriu, Veton Elshani, i cili tha se zjarri është fikur nga patrulla dhe se dëme ka pësuar dera e hyrjes së shtëpisë. “Dyshojmë se kemi të bëjmë me zjarrëvënie dhe se ky zjarr është shkaktuar nga një koktej i molotovit”, tha Elshani, duke shtuar se policia është duke punuar për ndriçimin e rastit.

Në “Facebook”, Krasniqi tha se shtëpia ishte ndërtuar nga Qeveria e Kosovës, për ta mbështetur kthimin e banorëve në këtë lagje shumetnike. Ai e akuzoi presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, për, siç tha,

nxitje të mosdurimit etnik. Sipas tij, Vuçiqi “ka mbetur i mbyllur në propagandën e tij” dhe “ka humbur kontrollin e strukturave paralele në pjesën veriore”. “Qeveria e Republikës së Kosovës e denon fuqishëm këtë akt dhe as ky e asnjë sulm tjetër nuk e ndal kthimin e banorëve në pronat e tyre. Kërcënimet, shantazhet, pamfletet terroriste, nuk i frikësojnë qytetarët dhe as nuk e ndalojnë punën tonë për sigurimin e banimit të qëndrueshëm. Ky sulm është nxitje e mosdurueshmërisë etnike e cila nxitet nga Vuçiqi i cili ka mbetur i mbyllur në propagandën e tij dhe e ka humbur kontrollin e strukturave paralele në pjesën veriore. Atje, prej vitesh, kanë funksionuar struktura paralele të Serbisë”, ka thënë Krasniqi.

Në fund të muajit të kaluar, autoritetet e Kosovës i kanë mbyllur disa prej tyre, me arsyetimin se kanë vepruar



jashtë ligjeve të Kosovës. Ky veprim është dënuar nga Beogradi zyrtar, por edhe nga bashkësia ndërkombëtare, e cila e ka cilësuar të njëanshëm dhe të

pakoordinuar. Ajo kërkon nga Kosova që të gjitha çështjet që lidhen me situatën në veri t’i trajtojë në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve

me Serbinë, i cili ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian.

Qeveria e Kosovës thotë se veprimet e saj kanë për qëllim shtrirjen e rendit dhe ligjit.

## Zyrtarët e LV-së presin një delegacion nga zyra e BE-së, flasin për zgjedhjet e 9 shkurtit



PRISHTINË, 17 SHTATOR - Të martën në zyrën qendrore të Lëvizjes Vetëvendosje, sekretari organizativ Alim Rama, nënkryetarja e dytë e LV-së, Mrika Limani-Myrtaj, koordinatorja e Sekretariateve, Albana Gashi, Filiz Mustafa nga Koordinimi me Qendra dhe Alma Haxhija nga zyra ligjore, kanë pritur në takim delegacionin nga zyra e Bashkimit Evropian.

Temë e këtij takimi ishte çështja e zgjedhjeve qendrore që do të mbahen në shkurtin e vitit të ardhshëm, me ç’rast

kanë bashkëbiseduar për hapat përgatitorë, situatën e përgjithshme, si dhe kampanjën zgjedhore të Lëvizjes Vetëvendosje. “Është theksuar fakti që ky proces zgjedhor do të jetë i pari pasi që një qeveri përfundon mandatin e rregullt të saj katërvjeçar. Temë shoqëruese e diskutimeve padyshim që ka qenë dhe ligji i ri i zgjedhjeve, me theks të veçantë votimi i mërgatës, që këtë herë mundësohet edhe në vendet ku ata jetojnë”, ka njoftuar LV-ja.

Sipas LV-së, në këtë takim u diskutua për situatën e sigurisë në pjesën veriore të Republikës, ku u potencua fakti që për herë të parë qytetarët mund të votojnë të lirë dhe pa presion nga bandat kriminale falë ndryshimit të shtrirjes së rendit dhe ligjit nga ana e qeverisë. “Lëvizja Vetëvendosje është e gatshme për proceset zgjedhore, e mirëstrukturuar dhe e bindur drejt rezultateve pozitive që më shumë se secilit u shërbejnë qytetarëve”, ka njoftuar ky subjekt politik.





KRYEMINISTRI ALBIN KURTI KA TAKUAR TË MARTËN KRYETARIN E ZUBIN POTOKUT DHE ATË TË ZVEÇANIT

## Kryetari i Zubin Potokut dhe ai i Zveçanit kërkojnë përkrahje nga qeveria për investime në infrastrukturë

Kryeministri Kurti ka takuar kryetarin e Zubin Potokut, Izmir Zeqiri dhe atë të Zveçanit, Ilir Peci, me të cilët ka diskutuar për punën, arritjet e deritashme dhe sfidat e trashëguara dhe mundësitë për t'i trajtuar dhe adresuar ato gjatë pjesës së mbetur të mandatit qeverisës. Ata e kanë njoftuar kryeministrin edhe për mbarëvajtjen e procesit të konvertimit të dokumenteve dhe pajisjes së qytetarëve me dokumente të Republikës së Kosovës, por edhe për rezultatet e deritanishme të masave të punësimit të mbështetura nga qeveria

**EPOKA E RE**

**Mal QORRAJ**

Prishtinë, 17 shtator - Kryeministri Albin Kurti, i shoqëruar nga ministri për Komunitete dhe Kthim, Nenad Rashiq dhe ministri i Administrimit e Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, kanë mirëpritur të martën në mëngjes kryetarin e komunës së Zubin Potokut, Izmir Zeqiri, nënkryetarin Sefer Veselin dhe kabinetin e drejtorëve komunalë me një përbërje shumetnike. Bashkë kanë diskutuar për punën, arritjet e deritashme, sfidat e trashëguara dhe për mundësitë për t'i trajtuar dhe adresuar ato gjatë pjesës së

mbetur të mandatit qeverisës. Kryetari Zeqiri nënvizoi angazhimin dhe përkushtimin për shërbime sa më të mira komunale dhe për gjithëpërfshirje të të gjitha komuniteteve në jetën sociale dhe institucionale. Ai theksoi se nga takimet me qytetarët është vërejtur interesim i shtuar për pjesëmarrje dhe bashkëpunim në proceset vendimmarrëse. Me qëllim të rritjes së kapacitetit dhe përmirësimit të shërbimeve për qytetarët e Zubin Potokut, drejtues të kësaj komune thanë se po punohet për shtimin e stafit të administratës komunale. Ata e njoftuan kryeministrin në lidhje me mbarëvajtjen e procesit të

konvertimit të dokumenteve dhe pajisjes së qytetarëve me dokumente të Republikës së Kosovës, si dhe për rezultatet e deritanishme të masave të punësimit të mbështetura nga qeveria, ndërkohë që veçuan fillimin e procesit të mbledhjes së tatimit në pronë dhe procesit të vlerësimit të pronave. Gjatë takimit u diskutua edhe rreth projekteve ekzistuese, ato që kanë përfunduar dhe që janë në proces të punës, në të njëjtën kohë edhe për projekte të reja. Nga drejtuesit e komunës u veçua rëndësia dhe nevoja e investimeve në infrastrukturë, sidomos në fshatrat e thella të komunës, por edhe e programeve të

mbështetjes dhe mirëqenies sociale.

Në këtë drejtim ata e njoftuan kryeministrin Kurti mbi përgatitjet që Zyra e Kryetarit dhe drejtoritë komunale po bëjnë për seancën e kuvendit komunal, në të cilin pritet të diskutohet dhe votohet buxheti komunal për vitin 2025, projekte investive, nga i cili do të reflektohen edhe në Ligjin për Ndarjet Buxhetore për vitin 2025.

Kryeministri Kurti dhe ministrat e pranishëm në takim e falënderuan kryetarin Zeqiri, drejtuesit e stafin e komunës së Zubin Potokut për angazhimin e përditshëm dhe gatishmërinë për bashkëpunimin e ngushtë me nivelin qendror, duke i ofruar njëkohësisht përkrahje në adresimin dhe realizimin e kërkesave në interes të komunës. Në vazhdim të takimeve me kryetarët e komunave veriore, Kurti ka takuar të martën edhe kryetarin e komunës së Zveçanit, Ilir Pecin, nënkryetaren Natasa Tomanić dhe drejtorët komunalë. Edhe në këtë takim temë

qendrore ishte qeverisja komunale, shërbimet e reja, përfshirë ato që ofrohen nga agjencitë qendrore, sikurse Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve dhe Agjencia e Regjistrimit Civil, të cilat tashmë janë funksionalizuar në komunën e Zveçanit.

Kryetari Ilir Peci e njoftoi kryeministrin me projektet e përfunduara, 12 sosh, gjatë mandatit tij dhe për projektet që janë në proces të zbatimit. U veçua praktika e takimeve të rregullta javore ndërmjet drejtuesve komunalë dhe qytetarëve të të gjitha komuniteteve, gjë që dëshmon nivelin e mirë të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve, masat mbështetëse të komunës për banorë në fushën e bujqësisë, nga të cilat shumica e përfituesve vijnë nga radhët e komunitetit serb, masat e punësimit të mbështetura nga qeveria, e prej të cilave deri më tani 80 qytetarë janë punësuar, si dhe bashkëpunimin e afërt të komunës me Ministrinë e



# Raundi i ri i bisedimeve në Bruksel përfundoi pa takim trepalësh

**BRUKSEL, 17 SHTATOR** - Kryenegociatori i Kosovës, Besnik Bislimi dhe ai i Serbisë, Petar Petkoviç, nuk kanë zhvilluar takim trepalësh me të dërguarin e posaçëm të BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, të martën në Bruksel.

Bislimi u takua dy herë me Lajçakun dhe tha se takimi trepalësh me Petkoviçin dështoi pasi Serbia e "kushtëzoi agjendën e takimit me kërkesa të papranueshme për Kosovën". Ai nuk shpjegoi se çfarë kërkesash shtoi pala serbe për ta kushtëzuar pjesëmarrjen në takim trepalësh. "Në agjendë kishte vetëm një pikë, ecja përpara me zbatimin e marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve. Por u theksua se tema shtesë mund të diskutohen nëse të dyja palët pajtohen. Ne u pajtuam për këtë, por Serbia donte ta kushtëzonte pjesëmarrjen e saj në takim me tema shtesë në agjendë, të cilat nuk ishin të pranueshme për palën kosovare", tha Bislimi.

Në takimin dypalësh me Lajçakun, Bislimi tha se temë kryesore ka qenë rruga përpara për zbatimin e Marrëveshjes Bazë

dhe aneksit të implementimit në Ohër, për të cilat Kosova dhe Serbia u pajtuam më 2023. "Tema kryesore në takim me Lajçakun ka qenë rruga përpara në zbatimin e Marrëveshjes Bazë dhe aneksit të implementimit në Ohër. Kemi folur edhe për atë se deri ku kemi mbërritur me disa marrëveshje të tjera dhe ku kemi hasur në probleme", shtoi ai.

Për herë të fundit Bislimi dhe Petkoviç janë takuar në fillim të korrikut, por pa ndonjë rezultat. Bislimi e ka akuzuar atëkohë palën serbe se dëshiron vetëm zbatim të pjesshëm të Marrëveshjes Bazë për normalizimin e marrëdhënieve, ndërsa Petkoviç ka thënë se pala e Kosovës nuk dëshiron ta themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe.

Marrëveshja Bazë, e cila përfshin edhe obligimin për themelimin e këtij asociacioni, është arritur në shkurt të vitit të kaluar, por nuk ka gjetur zbatim.

Sipas burimeve në BE, në takimet e sotme pritet të diskutohen hapat për zbatimin e saj.

Këtyre takimeve u kanë paraprirë udhëtimet e të dërguarit të



posaçëm të BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, në Prishtinë dhe në Beograd. Kosova dhe Serbia janë në negociata për normalizimin e marrëdhënieve qysh në vitin 2011.

Përveç në nivel

kryenegociatorësh, bisedimet zhvillohen edhe në nivel politik. Megjithatë, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, nuk janë takuar qysh nga shtatori i vitit të kaluar dhe të dy kanë akuzuar njëri-tjetrin për

qasje jokonstruktive.

BE-ja, në anën tjetër, përsërit se dialogu është e vetmja mënyrë për normalizimin e marrëdhënieve. Ajo e ka kushtëzuar integrimin evropian të të dyja vendeve me përparimin në dialog.



Administrimit të Pushtetit Lokal. Gjatë takimit u diskutua edhe rreth sfidave të trashëguara në komunë, për nevojën për investime publike në zgjerimin, funksionalizimin dhe përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit, sidomos në fshatrat më të thella të komunës, në infrastrukturë dhe në ndriçim publik, që do ta rriste sigurinë publike.

Me këtë rast u theksua rëndësia e përgatitjeve dhe miratimi i buxhetit komunal sipas afateve të

Qarkores Buxhetore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Trasnfereve, në mënyrë që buxheti për projektet aktuale dhe ato të reja të reflektojë në Ligjin për Ndarje Buxhetore për vitin 2025.

Kryeministri Kurti falënderoi kryetarin Peci dhe drejtorët komunalë për punën e tyre të përditshme, angazhimin për përmirësimin e shërbimeve dhe mirëqenien e qytetarëve, pa dallim, si dhe për bashkëpunimin e mirë me institucionet qendrore.

## Kurti i hedh poshtë kërkesat e Vuçiqit si "jopaqësore" dhe "fushatë agresive"

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i ka hedhur poshtë si "jopaqësore" dhe pjesë të një "fushate agresive për konflikte të reja" kërkesat e presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, për kthimin e serbëve në

institucionet e Kosovës.

Javën e kaluar Vuçiqi bëri thirrje për riintegrimin e serbëve nga veriu në institucionet e Kosovës, duke kërkuar, ndër të tjera, shpallje të zgjedhjeve të reja lokale në veri, kthimin e serbëve në Policinë e Kosovës dhe në gjyqësor, si dhe tërheqjen e njësive speciale të Policisë së Kosovës nga rajoni i veriut.

I pyetur të martën në Prishtinë rreth kërkesave të presidentit serb, Kurti tha: "Kërkesat e tij, masat e tij, bëhen nga një dëshpërim dhe paraqesin joracionalitet dhe nuk

janë aspak paqësore por, përkundrazi, pjesë e fushatës agresive për konflikte të reja që padyshim nuk kanë vend as në Kosovë".

Kjo është hera e parë që Kurti i komenton thirrjet e Vuçiqit për riintegrimin e serbëve në veri të Kosovës, të cilat u mirëpritën nga Bashkimi Evropian si një lëvizje pozitive.

Qindra pjesëtarë të komunitetit serb në veri dhanë dorëheqje nga institucionet e Kosovës, përfshirë komunat, policinë, gjykatat dhe prokurorinë, në nëntor të vitit 2022. Kjo pasoi indinjatën e tyre me një vendim të Qeverisë së Kosovës për t'i zëvendësuar targat serbe të makinave me targa të Kosovës.

Nga ajo kohë kryetarët e komunave Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq u zëvendësuan me udhëheqës shqiptarë, pasi komuniteti shumicë serb në zonë i bojkotoi zgjedhjet.

Në gjykata, prokurori dhe polici, punonjësit serbë nuk u kthyen.

Kurti tha se kërkesat që ai i ka bërë më herët drejtuar Serbisë "janë paqësore dhe racionale" krahasuar me ato të liderit serb. "Së pari duhet të flisni për tri kushtet që i kam vënë unë... dorëzimi tek autoritetet kosovare i Millan Radoiçiqit, nënshkrimi i Marrëveshjes [për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve] dhe tërheqja e letrës e ish-kryeministres [serbe Ana Bernabiq], e cila tha që nuk e pranon as pavarësinë e Kosovës, as ulësen në OKB për Kosovën dhe as nuk e respekton integritetin territorial të Kosovës", tha Kurti.

Javën e kaluar Prokuroria Speciale e Kosovës ngriti aktakuzë ndaj 45 personave - në mesin e tyre edhe Millan Radoiçiq - për sulmin e armatosur në Banjskë.



## Interesim i madh për ekspozitën “Gursel dhe Pranvera Sylejmani”



EPOKA E RE

Qendresa RAMA

SUHAREKË, 17 SHTATOR - Të hënën në mbrëmje është përruar shtëpia e re e kulturës “Ukë Bytyçi” në Suharekë dhe, krahas saj, është hapur edhe ekspozita “Gursel dhe Pranvera Sylejmani”. Kjo ekspozitë sjell një përvojë unike që ndërthur artin, trashëgiminë dhe emocionet familjare, duke e shndërruar atë në një nga ngjarjet qendrore të Festarit 2024.

Në hapjen e kësaj ekspozite morën pjesë personalitete nga politika dhe kultura, në mesin e tyre edhe presidentja Vjosa Osmani, kryeministri Albin Kurti, ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku, kryetari i Therandës, Bali Muharremaj, deputeti dhe përfaqësues nga pushteti lokal. Përshtypjet e këtyre personaliteteve dhe mysafirëve të tjerë për këtë ekspozitë ishin të mëdha.

Në organizimin e Refki Gallopenit dhe me kurator Skënder Boshtrakaj, ekspozita përfshin punimet e Pranvera dhe Gursel Sylejmanit, babë e bijë, që përmes artit të tyre shprehin një histori të thellë trashëgimie dhe dashurie familjare.

Pranvera Sylejmani, e njohur për stilin e saj të veçantë, sjell një koleksion që përqendrohet në traditat shqiptare dhe përfaqëson figura të rëndësishme të kulturës dhe jetës shqiptare. Në krah të saj qëndron babai i saj, Gursel Sylejmani, dëshmor i kombit, i cili, përmes punimeve, përçon emocione të thella.

Një pjesë e rëndësishme e ekspozitës është një letër prekëse që Gurseli i ri i ka dërguar të dashurës së tij nga burgu, një dokument që reflekton dashurinë, shpresën dhe qëndrueshmërinë e tij, si dhe dimensionet intelektuale dhe artistike të veprës së tij.

Artistja Pranvera Sylejmani në



“Facebook” ka falënderuar iniciatorin dhe realizuesin e kësaj ekspozite, Refki Gallopeni dhe kuratorin Skender Boshtrakaj, të cilët sollën përpara komunitetit artistik dhe dashamirësve të artit këtë ekspozitë, e cila për të bartë një trashëgimi shpirtërore të

veçantë. “Kjo ekspozitë mban edhe emrin e babait tim, Gurselit, pranë të cilit, si fëmijë, pata fatin të hedhja ngjyra dhe vijat e para naive në telajon e tij. Duke qenë pranë tij, gjithmonë imagjinoja që një ditë do të ndiqja hapat e tij. Sot, si e rritur, e kuptoj që hapi i tij nuk mund

të arrihet lehtësisht, sepse ai ishte një hap i madh dhe i veçantë. Po ashtu, tani e kuptoj që ato ngjyra dhe vija që i shihja si fëmijë në telajon e tij nuk ishin thjesht vizatime, por simbolizonin vuajtjet dhe aspiratat e tij - vuajtjet përgjatë rrugës së lirisë dhe shpresën që një ditë, si kjo e sotmja, fëmijët e tij dhe të gjithë të tjerët të mund të zhvillojnë lirisht veprimtarinë e tyre, pavarësisht se ai vetë nuk e pati këtë fat”, ka thënë ajo.

Sylejmani ka theksuar se është jashtëzakonisht e lumtur dhe thellësisht mirënjohëse ndaj nënës së saj, Alije Sylejmani, e cila kurrë nuk u lodh të mbante mbi supë peshën e përgjegjësisë për emrin e babait dhe për fëmijët, duke i udhëhequr gjithmonë drejt gjurmëve të tij. “Jam mirënjohëse gjithashtu ndaj secilit prej jush që ishte prezent në këtë ekspozitë, dhe respektoni vlerat artistike dhe kombëtare”, ka shkruar artistja Pranvera Sylejmani.



## Përrurohet shtëpia e kulturës “Ukë Bytyçi”, një prej qendrave më të mira në Kosovë

SUHAREKË, 17 SHTATOR - Presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti kanë marrë pjesë në përrurimin e shtëpisë së kulturës “Ukë Bytyçi” në Suharekë. Presidentja Vjosa Osmani ka thënë se në këtë vend e kaluara jonë, e cila personifikohet me jetën dhe veprën e Ukë Bytyqit, do të gërrshetohet mrekullisht me të tashmen dhe të ardhmen e të rinjve tanë. “Tashmë të rinjtë

tanë do të kenë mundësi më të madhe për ta zhvilluar talentin e tyre, duke nderuar komunën, shtetin dhe flamurin e Kosovës”, ka deklaruar Osmani. Ndërkaq Kurti gjatë fjalës së tij ka thënë se shtëpia e re e kulturës “Ukë Bytyçi” në Suharekë, që u përrura mbrëmë, është një prej qendrave më të mira në Kosovë për nga hapësira, për nga funksioni dhe për nga

mundësitë që i ofrohen komunitetit artistik edhe përtej komunës së Suharekës. “Ajo do të shërbejë si shtëpi e artit dhe kulturës, do të jetë në dispozicion për të gjithë ata të cilët duan të kontribuojnë në pasurimin e jetës kulturore dhe shoqërore të Suharekës e që, rrjedhimisht, bashkërisht kontribuojmë në ndërtimin e një shoqërie më të pasur intelektualisht dhe shpirtërisht”, ka thënë Kurti.





# Kosova dhe Gjermania diskutojnë për çështje sociale, shqetësues largimi i infermierëve dhe mjekëve

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqene Sociale dhe Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere ka pritur të martën në takim një delegacion nga Komisioni i Punës dhe Çështjeve Sociale nga parlamenti gjerman.

Largimi i infermierëve dhe mjekëve në shtetet e BE-së, sidomos në Gjermani, ishte çështje diskutimi mes dy delegacioneve. Takimi synon të gjejë mënyra bashkëpunimi ndërmjet të dyja vendeve, të cilat kanë bashkëpunim të ngushtë në fushën e shëndetësisë.

Kryetarja e Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqene Sociale, Fatmire Kollçaku, vlerësoi mundësinë e bashkëpunimit në funksionalizimin e ndërmarrjeve sociale. "Qeveria po subvencionon qytetarët në pajisje eficiente dhe po bëjmë ndryshime të mëdha në pjesën e legjislativit për ta përmirësuar jetën sociale në

Kosovë. Kosova dhe Gjermania kanë një bashkëpunim të madh në fushën e shëndetësisë. Dëshira jonë mbetet që mjekët tanë të përfitojnë nga avancimet në mjekësi në shtetin tuaj dhe këto përvoja t'i sjellin në vendin e tyre. Pra qëllimi ynë është ata të kthehen në Kosovë dhe të kontribuojnë në vendin tonë. Sigurisht për ne është me rëndësi të dimë për mirëqenien e të gjithë kosovarëve në Gjermani, jo vetëm për ata që janë atje me kontrata pune, por edhe për kosovarët që kanë shtetësi gjermane", tha ajo.

Deputeti gjerman Carl-Julius Cronenberg theksoi rëndësinë e sigurimit shëndetësor në Kosovë që, sipas tij, do të krijonte një standard të ri në fushën e shëndetësisë në Kosovë. "Kosova pas disa viteve do të mund t'i bashkohet BE-së dhe kjo na gëzon neve, me gjithë vështirësitë që po kalon tash në fazën e dialogut me shtetin fqinj. Aspektet e shëndetësisë, nuk është pse Gjermania është atraktive për profesionistët shëndetësorë, por që Kosova ka nevojë për një sistem solid shëndetësor, duke nisur nga



sigurimet shëndetësore, dhe çka mund të bëhet është një bashkëpunim më i madh ndërmjet klinikave të të dyja vendeve. Gjermania ka interes ta shohë Kosovën në BE, për ta pasur më lehtë bashkëpunimin ndërmjet të dyja vendeve", tha Cronenberg. Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Armend Zemaj, tha se është e nevojshme që të gjendet

një mundësi për kontroll shtetëror për pjesën deficitare të profesionistëve shëndetësorë të Kosovës, që të ketë marrëveshje ndërmjet të dyja vendeve, në specializime dhe përvoja të tjera, që ndihmojnë shëndetësinë në Kosovë dhe jo vetëm të ikin profesionistët. Ndërkaq deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Bekim

Haxhiu, përmendi sfidat që kanë qytetarët në trajtim shëndetësor në mungesë që sigurimeve shëndetësore.

Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Pal Lekaj, ka kërkuar nga Gjermania që të ketë ndikim tek investitorët e huaj që të vijnë të investojnë në Kosovë pasi, sipas tij, vendi ka papunësi dhe varfëri të madhe.

## Përfundon punimet konferenca ndërkombëtare për ndryshimet klimatike dhe mjedisin në Kosovë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 SHTATOR - U mbajt konferenca e tretë ndërkombëtare, e organizuar nga Qendra për Energji dhe Qëndrueshmëri (QEQ) e Universitetit të Prishtinës (UP), në bashkëpunim me aktivitetin Adapt të USAID-it në Kosovë, GIZ Kosova dhe Rrjetin CSR Kosova, me temën "Inovacioni për një të nesërme të qëndrueshme: dialog mes institucioneve akademike, industrisë dhe qeverisë".

Konferenca dyditore ofroi një platformë për ndarjen e hulumtimeve, inovacioneve dhe praktikave më të mira për qëndrueshmërinë mjedisore dhe ndryshimet klimatike.

Konferenca u përshëndet nga prorektorja e Universitetit të Prishtinës, prof. Arta Basha-Jakupi, e cila shprehu angazhimin e UP-së, veçanërisht përmes Qendrës për Energji dhe Qëndrueshmëri, në dialogun global për qëndrueshmëri dhe theksoi përkushtimin për të sjellë ndryshime reale përmes dijes



dhe inovacionit.

Ajo vuri theksin në rëndësinë e bashkëpunimit midis akademisë, industrisë dhe qeverisë, duke nënvizuar se "inovacioni kërkon guxim dhe kreativitet për të menduar përtej normave dhe për të krijuar rrugë të reja".

Drejtuesja e misionit të USAID-it në Kosovë, Eileen Devitt, theksoi se

qeveria e ShBA-së kishte investuar mbi 13 milionë dollarë për zhvillimin e teknologjive dhe politikave për t'i zbutur ndikimet e ndryshimeve klimatike në Kosovë.

Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, vuri në dukje angazhimin e qeverisë për të zhvilluar politika klimatike, duke

përfshirë përmirësimin e sistemit për monitorimin dhe verifikimin e gazrave serrë, si dhe modernizimin e Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës.

Sebastian Leuschner, atashe për çështje klimatike në ambasadën e Gjermanisë në Kosovë, përmendi mbështetjen e Gjermanisë për krijimin e skemës për auditorët e

energjisë, duke theksuar ritjen e numrit të auditorëve në 226 profesionistë si një arritje e rëndësishme për Kosovën.

Prof. Majlinda Daci, drejtoresha e QEQ-it, theksoi se ndryshimet klimatike ishin një problem global që ndikonin ndjeshëm në Kosovë, ku përmbajtjet dhe thatësitat po dëmtonin sektorët jetësorë, si bujqësia dhe burimet ujore. Edhe pse Kosova nuk e kishte nënshkruar marrëveshjen e Parisit, ajo ishte angazhuar për të arritur objektiva të rëndësishme për energjinë dhe klimën.

Në konferencë u theksua rëndësia e bashkëpunimit ndërsektorial për një tranzicion energjetik të drejtë, ku përfshihen sektorët privatë dhe civilë. Folësit diskutuan qasjet inovative për qëndrueshmëri, adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike dhe financimin e transformimit të gjelbër.

Punimet e konferencës vazhduan me diskutime mbi strategjitë për biznes të qëndrueshëm dhe politikën për një të ardhme më të gjelbër.

## Ministri i Mbrojtjes: Për tri vjet i kemi investuar 249 milionë euro në armatim

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka thënë se gjatë këtyre tri vjetëve kanë investuar 249 milionë euro në sistemet e armatimit.

Maqedonci tha se kjo shumë është pa përfshirë buxhetin e sivjetmë.

Këtë deklaratë ai e dha në

emisionin e mëngjesit në "Klan Kosova". "Janë orientuar sipas konceptit të blerjeve shtet me shtet. Pra, blerjet janë investuar në bashkëpunim me ministrinë përkatëse të vendeve të NATO-s prej të cilave kemi prokuruar, dhe janë sipas standardeve të NATO-s, sepse

orientimi ynë është i qartë drejt anëtarësimit në NATO dhe Bashkimin Evropian", tha ai.

Ministri Maqedonci tha se blerjet realizohen duke u bazuar në planin gjithëpërfshirës të tranzicionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës.





## Murati priti në takim deputetët e parlamentit gjerman, flasin për fushën e punësimit

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekurani Murati, ka pritur të martën në takim deputetët e Komisionit për Çështje të Punës dhe Sociale të parlamentit gjerman. Takimi u fokusua në situatën ekonomike të vendit, me theks të veçantë në fushën e punësimit. Ministri Murati e njoftoi Komisionin për

Çështje të Punës dhe Sociale të parlamentit gjerman lidhur me kushtet e tregut të punës në Kosovë, duke përmendur rritjen e pjesëmarrjes së grave dhe të rinjve si një ndër të arriturat kryesore në këtë fushë.

Më tutje, deputetët gjermanë u njoftuan edhe lidhur me proceset që po ndërmerren nga aspekti administrativ,

përfshirë këtu riorganizimin e Agjencisë së Punësimit, ngritjen e kapaciteteve të Inspektoratit të Punës e kështu me radhë. Së fundmi, ministri dhe deputetët gjermanë diskutuan lidhur me mundësitë e bashkëpunimit, si dhe shkëmbimin e praktikave më të mira mes të dyja vendeve.



## Fillon punimet Konferenca e Javës së Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Ka filluar punimet edicioni i shtatë i Konferencës së Javës së Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë (KSDW 2024 - Kosovo Sustainable Development Week). Në hapjen e punimeve të Javës së Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë kanë folur kryeministri Albin Kurti, ministrja gjermane për Evropë dhe Klimë, Anna Luhrmann dhe zëvendëshefja e Zyrës së BE-së në Kosovë, Eva Palatova.

Në fillim të fjalës së tij, kryeministri Kurti tha se Republika e Kosovës përgjatë viteve të fundit ka bërë përparim të madh në tranzicionin energjetik dhe agjendën klimatike duke treguar vizionin e angazhimit të madh për një të ardhme të qëndrueshme.

Krahas përkrahjes institucionale, kryeministri Kurti foli edhe për investimet në ndërtimin e kapaciteteve të ripërtëritshme, ku me këtë rast theksoi se është planifikuar ndërtimi i 950 megavatëve të energjisë së ripërtëritshme përmes projekteve konkurruese. Ai veçoi organizimin

e ankandit të energjisë diellore me kapacitet prej 100 MW, si shembull suksesi, dhe shtoi se të njëjtin sukses e presin për projektet konkurruese për 150 MW të erës.

Edhe pse Kosova nuk është anëtare e Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNF), kryeministri tregoi se janë ndërmarrë veprime konkrete për të kontribuar në përpjekjet globale për klimën përmes Kontributit Kombëtar të Përcaktuar Vullnetar (NDC). Në këtë drejtim, qëllimi kryesor është shkurtimi 8.95 milionë tonë dyoksid karboni ekuivalent deri në vitin 2030, që përfaqëson një ulje prej 16.3 % krahasuar me nivelet e emetimit të vitit 2016.

Para të pranishmëve, kryeministri potencoi se një ndër projektet më inovative në rajon, e më gjerë, është Solar4Kosovo përmes të cilit do të sigurohet ngrohje qendrore prej energjisë diellore për 60 000 qytetarë, dhe 100 MW të energjisë diellore për KEK-un duke e bërë atë pjesë të tranzicionit të gjelbër.



## Shtesat për fëmijë, Ministria e Financave nis verifikimin shtesë të disa llogarive të prindërve



PRISHTINË, 17 SHTATOR - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka dalë me një njoftim rreth verifikimit shtesë për disa llogari të prindërve lidhur me shtesat për fëmijë. MFPT ka thënë se ky veprim është bërë për t'u siguruar se ata dhe fëmijët e tyre jetojnë në Kosovë, derisa ka thënë se ata që s'kanë pranuar ndonjë njoftim në e-Kosova dhe e-mail adresat e tyre, s'kanë nevojë të

ndërmarrin ndonjë veprim. "Në kuadër të programit për shtesat për fëmijë është një numër i caktuar i prindërve, llogaria e të cilëve është përzgjedhur për verifikim shtesë për t'u siguruar se ata dhe fëmijët e tyre jetojnë në Kosovë. Të gjithë këta prindër kanë pranuar njoftimin në eKosova dhe në email adresat e tyre, me hapat e nevojshëm për ta kompletuar verifikimin

shtesë dhe për ta riaktivizuar llogarinë e shtesave për fëmijë. Nëse ju nuk keni pranuar njoftimin e tillë nga eKosova e as email nga MFPT, atëherë nuk keni nevojë të ndërmerrni ndonjë veprim. Programi i shtesave për fëmijë vazhdon si zakonisht, dhe ju do t'i pranoni shtesat sikurse çdo muaj në llogarinë tuaj", ka njoftuar Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

## FMN-ja vazhdon ta mbështesë ATK-në

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Sikurse çdo vit tjetër, Fondit Monetar Ndërkombëtar ka vazhduar mbështetjen ndaj autoritetit tatimor të Kosovës.

Vizita e radhës e këshilltarit regional të FMN-së për administrimin e të hyrave, Jim Sorensen, në Administratën

Tatimore të Kosovës, u fokusua në gjendjen aktuale të këtij institucioni.

Diskutimet me drejtorin e përgjithshëm të ATK-së, Ilir Murtezaj, ishin mbi rritjen e përbushjes tatimore, digjitalizimin e ATK-së dhe menaxhimin e borxheve

tatimore. Po ashtu, u fol për ndërmarrjen e hapave konkretë për ta përmirësuar transparencën dhe efikasitetin për mbledhjen e të ardhurave, duke siguruar një administratë të fortë dhe të qëndrueshme.





# Libër kot, i mërzitshëm dhe i pakuptimtë: Kryevepra që shpëtoi nga grumbulli i dorëshkrimeve të refuzuara



**Nga: Greg MCKEVITT / BBC**

“Shkruaj për atë që di” është këshilla që shpesh u jepet autorëve aspirues, dhe vepra Lord of the Flies [botuar në gjuhën shqipe me titullin Perëndia e mizave] është një shembull spektakolar i asaj se si klishtë mund të përmbajnë disa të vërteta. Si mësues në një shkollë për djem dhe si dëshmitar i çnjerëzores gjatë Luftës së Dytë Botërore, William Golding [1911–1993] përmbloodhi këtë njohuri dhe përvojë në romanin e tij të parë, në një rrëfim për djemtë e një anijeje të përmbytur që shndërrohen në egërsira në një ishull të shkretë. Rrëfimi i tij rezonon te shumë breza lexuesish dhe shërben si një paralajmërim i zymtë se të këqijat e Gjermanisë naziste mund të përsëriten kudo. Golding ishte gati 43 vjeç kur libri Perëndia e mizave u botua për herë të parë. Ideja e tij ishte një ripërpunim cinik – në kontekstin e shekullit XX – i romanit të vitit 1857 nga R.M. Ballantyne, Ishulli Koral [The Coral Island], që flet për një grup nxënësish britanikë të shpëtuar nga një anije e përmbysur, të cilët civilizojnë një ishull të shkretë duke e shndërruar në një shesh për argëtim dhe lojëra. Pjesa më e madhe e dorëshkrimit të tij original ishte shkruar me dorë në fletore, gjatë



kohës së orëve mësimore. Ai madje punonte me romanin gjatë mësimeve, sa herë që nxënësit e tij ishin të zënë me leximin e librave. Disa prej tyre kishin për detyrë të numëronin fjalët që ai kishte shkruar në faqe. Në vitin 1953, Golding e dërgoi romanin e tij tek nëntë botues, por të gjithë e refuzuan atë. I patruar, ia ofroi dorëshkrimin shtëpisë botuese Faber and Faber, një prej firmave më prestigjioze në Londër. Dorëshkrimi kaloi në duart e Charles Monteithit – një redaktor i ri, i cili ishte punësuar vetëm disa muaj më parë në shtëpinë botuese. Shenjat e para nuk ishin premtuese. Në emisionin Bookmark të BBC-së, në vitin 1984, ai tha: “Kishte një lloj gjëje të veçantë që mund të dallohej; ishte një dorëshkrim i vjetër që kishte kaluar nëpër duar të shumë botuesve, para se të mbërrinte tek ne. Ishte një dorëshkrim i madh me faqe të zverdhura që kishin nisur të rudhen dhe me një ose dy njolla të filxhanëve të çajit ose të gotave të verës, me pika kafeje dhe çaji të derdhura, i lidhur me karton të keq ngjyrë kafe, me një letër të shkurtër formale”. Një nga lexueset e botuesve e kishte dhënë tashmë verdiktin e saj mbi dorëshkrimin e Goldingut, duke e hedhur poshtë atë si një “fantazi absurde dhe jointerese”. Së bashku me një

“R” të rrethuar për “refuzim”, ajo shkroi: “I kotë dhe i mërzitshëm. I pakuptimtë”. Për fat të mirë për Goldingun, Monteithi i dha librit një shans tjetër dhe vendosi ta shpëtonte nga harresa. Ai tha: “Ja hodha një sy dhe duhet të them që fillimi nuk më tërhoqi aspak, por vazhdova të lexoja dhe u përfshiva nga ai. Dhe, që atëherë thashë ‘duhet ta marrim seriozisht’”. Ai e bindi shtëpinë botuese që të botonte librin, por Goldingu fillimisht duhej të bënte disa ndryshime të rëndësishme në tekst. Gjithashtu, duhej të hiqej titulli i tij original, Të huaj nga brenda [Strangers from Within]. Sipas biografit të Goldingut, profesorit John Carey, dorëshkrimi original ishte një roman fetar, “shumë më ndryshe nga Perëndia e mizave që shumica e njerëzve kanë lexuar”. Duke folur në dokumentarin e vitit 2012, Ëndrrat e William Goldingut [The Dreams of William Golding], Carey tha se autori u bë fetar pas Luftës së Dytë Botërore, pasi kishte shërbyer në një destroyer të Marinës Mbretërore, por pas korigjimeve të redaktorit të tij, Monteithit, këto elemente u hoqën. “Golding pranoi, pranoi, pranoi, derisa përfundimisht libri doli si një roman laik; nuk supozon ndonjë ndërhyrje të mbinatyrshe”, tha ai.

Përvoja e luftës i dha Goldingut një ndjesi të thellë për aftësinë e njeriut për të keqen dhe një zhgënjim me politikën idealiste të rinisë së tij. Perëndia e mizave ishte paralajmërimi i tij se nazizmi, i cili përfshiu Gjermaninë në vitet 1930, mund të ndodhte në çdo vend të qytetëruar. Duke folur në emisionin The South Bank Show në vitin 1980, ai shpjegoi se si lufta i kishte transformuar qëndrimin ndaj natyrës njerëzore. “Thjesht ndryshoi, sepse, pak nga pak, zbuluam se çfarë kishin bërë nazistët. Këtu ishin këta njerëz shumë të civilizuar, që bënin gjëra të pamundura. Më kujtohet që në ato ditë i thoja vetes: ‘Po, mirë, unë brenda meje kam një nazist; duke pasur rrethanat e duhura, mund të kisha qenë nazist ... Pak nga pak, kur mësova gjithnjë e më shumë për atë që kishte ndodhur, kjo vërtet ndryshoi pikëpamjen time për atë se çfarë ishin të aftë njerëzit dhe, për rrjedhojë, se cila ishte natyra njerëzore. Kështu, mjetet politike më dukeshin sikur ranë përtokë përballë aftësisë së njeriut për të keqen absolute’”. Edhe pse Perëndia e mizave u prit mirë nga kritika, vetëm pas publikimit të tij në ShBA, dhe veçanërisht pas botimit të versionit të vitit 1959, Goldingu u bë një autor bestseller ndërkombëtar dhe filloi të fitonte shuma të mëdha honorarësh. Ky sukses e lejoi të

linte punën e tij si mësues dhe të bëhej shkrimtar me kohë të plotë. “Nuk më pëlqente ana sistematike e mësimeve; nuk jam një person shumë sistematik”, pranoi ai në emisionin Bookmark në vitin 1984. Për statusin e tij si një shkrimtar që shpërtheu në moshë më të madhe, ai tha se përparësia e tij ishte që kuptoi se duhej të ndalonte së imituarit shkrimtarët e tjerë. “Mendoj se kur isha 37 vjeç, kuptova të vërtetën e madhe: se duhet të shkruani librat tuaj dhe jo të askujt tjetër, dhe më pas gjithçka doli nga kjo”, tha ai për Monitor në vitin 1959. Si një autor original dhe me imagjinatë, Goldingu vazhdoi të shkruante libra të tjerë. Në vitin 1983, ai u nderua me Çmimin Nobel për Letërsinë “për romanet e tij të cilat, me mprehtësinë e artit narrativ realist dhe diversitetin dhe universalitetin e mitit, ndriçojnë gjendjen njerëzore në botën e sotme”. Për Goldingun, sekret i suksesit të tij ishte pothuajse një klishe. Ai i tha Bookmark-ut në vitin 1984: “Gjithashtu, jam tregimtar nga fillimi deri në fund. Ajo që ka rëndësi për mua është që të ketë një histori me një fillim, një mes dhe një fund”. /Telegrafi/





## Pira pasi mori çmimin 'Ylli i javës': Synojmë kreun e tabelës

"Epoka e re"

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e pestë i është dhënë futbollistit të FC Malisheva, Arbër Pira. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit në përbërje të Vllaznim Visokës, Selajdin Jerliut dhe Muhamet Sylejmanit. Ky komision vendosi që çmimi "Ylli i javës" për xhiron e katërt t'i takojë Piras, i cili për 90 minuta ishte lojtari më i rëndësishëm i skuadrës.

Arbër Pira, ndonëse mbrojtës, shënoi golin e epërsisë për 1:2 për skuadrën e tij dhe asistoi në golin e tretë, i cili vulosi fitoren e FC Malisheva në Klinë me rezultat 1:3. Aktualisht Malisheva ka arkëtuar 10 pikë dhe ndodhet e dyta në tabelë me një ndeshje më pak. "Ndeshja me Dukagjinin ka qenë shumë e mirë. Trajneri e ka përgatitur shumë mirë dhe ne e realizuam saktësisht atë që kishim planifikuar. Motivi ka qenë shumë i lartë dhe besoj se karakteri i shumë lojtarëve ka bërë diferencën në një fushë të rënduar që ne të marrim 3 pikë të merituar. Kam shënuar një gol dhe kam bërë një asistim. Ka qenë një ndjenjë shumë e mirë të ndihmoj ekipin. Pretendimet e FC Malisheva janë që të jemi në pjesën e lartë të tabelës dhe nuk kemi pretendime për të dalë kampion. Kemi një ekip shumë të mirë, të përbërë nga lojtarë të rinj shumë të talentuar, mendoj se mund të arrijmë lart me këtë ekip. Është një ndjenjë e mirë të shpallim 'Ylli i javës', një motiv shtesë për xhirot e ardhshme. Falënderoj stafin teknik dhe bashkëlojtarët, sepse pa ta nuk do të shpallesha më i miri i javës. Uroj që sa më shumë lojtarë të FC Malisheva të shpallen më të mirët e javës", ka thënë Pira për faqen zyrtare të FFK-së.



## Trepça sot përballet me Keravnosin në kualifikimet e Ligës së Kampionëve



Mitrovicë, 17 shtator - Kampionia e Kosovës në basketboll, Trepça, për herë të parë do të luajë në kualifikimet e Ligës së Kampionëve. Në garat kualifikuese që do të zhvillohen në Antalia të Turqisë, mitrovicasit shpresojnë të kualifikohen për herë të parë në grupet e kësaj gare.

Në turneun kualifikues do të përballen me skuadrën e Keravnos (Qipro), ndërsa fituesi i këtij takimi luan në gjysmëfinale kundër kampionit të Çekisë, Nymburk. Nëse arrin në finale, Trepça do të luajë përballë fituesit nga takimet në mes të: Kutaisi (Gjeorgji), Levice (Sllovakia) e Kalev/Cramo (Estoni). Në kualifikime janë 24 skuadra që do t'u bashkohet 28 skuadrave që tashmë janë përcaktuar për edicionin e ri. Ndeshja do të zhvillohet të mërkurën nga ora 13:00 sipas kohës lokale në Kosovë.

SHKURT

### Rashica në formacionin e javës në Turqi

Milot Rashica ka qenë fantastik këtë javë me fanellën e Besiktasit, përkundër që skuadra e tij nuk ka marrë fitore. Rashica ka luajtur për 67 minuta në derbin ndaj Trabzonsporit që përfundoi 1-1. Anësori vushtrias kishte 59 herë prekje të topit, dha tri pasime kyçe dhe krijoi edhe një rast të madh në këtë sfidë. Rashica fitoi gjashtë nga nëntë duelet, bëri dy spastrime dhe tri ndërhyrje të sakta në top. Përkundër që nuk shënoi dhe asistoi, paraqitja e tij u vlerësua lart nga SofaScore që i ka bërë vend në formacionin e xhiros së pestë në Superligën e Turqisë. 28-vjeçari këtë edicion ende nuk e ka gjetur golin në Superligën e Turqisë, teksa ka dy asistime.

### Rahoveci e fitoi derbin e parë ndaj Besës

Besa Famgas e Rahoveci kanë luajtur derbi të vërtetë në palestrën "Karagaçi" në Pejë. Në fund kampionët nga Rahoveci i morën dy pikë me vete. Rahoveci e fitoi 34:31 derbin e fillimit të edicionit, përkatësisht të xhiros së parë të Superligës së Kosovës në hendboll. Jon Muqolli i shënoi shtatë gola për Rahovecin. Nga gjashtë i realizuan Arbios Mushkolaj e Victor Alono, ndërsa pesë i kishte Mali Luzha. Olsi Mulaj e Agon Bajqinovci i shënuan nga tetë gola për Besa Famgasin. Gjashtë i kishte Jakub Cwieka.

### Asllani i lumtur pas rinovimit të kontratës me Interin

Interi ka njoftuar në faqen zyrtare për rinovimin e kontratës me Kristjan Asllanit deri më 30 qershor 2028. Mesfushori shqiptar, nëpërmjet një postimi në rrjetet sociale, është shprehur i lumtur për zgjatjen e bashkëpunimit me kampionët e Italisë. "Jam shumë i lumtur për të vazhduar këtë aventurë me ju, shihemi së shpejti në 'San Siro', ka shkruar Asllani. 22-vjeçari ka mbi 50 ndeshje me Interin.




## Është viti i Ismajlit, mbrojtësi 'kuqezi' po shkëlqen kudo

**EMPOLI, 17 SHTATOR** - Nuk ka dëshirë ta quajë një revansh, mirëpo Ardian Ismajli duket qartë se ka një brumë prej futbollisti profesionist dhe patrioti të vërtetë, pasi la pas çdo sfidë dhe u kthye më i fortë. Padyshim, e ka lënë pas faktin që u la në stol dhe nuk luajti asnjë minutë në Evropian

dhe këtë e tregoi me Kombëtaren ndaj Ukrainës, me performancën e tij që thjesht konfirmoi rikthimin e tij, edhe pse ishte titullar në Ligën e Kombeve. Sidoqoftë, kur një mbrojtës shënon, e kur për më tepër shpallet lojtari më i mirë i ndeshjes, kjo padyshim që ka një kuptim të madh. Jo vetëm

te Kombëtarja, por Ismajli duket se po arrin kulme edhe tek Empoli, teksa vetëm pasditen e së shtunës ishte padyshim protagonist i skuadrës së tij, në barazimin e madh përballë Juventusit, ku përballë kishte një prej sulmuesve më të mirë të Evropës, Dusan Vlahović. Në

skuadrën toscane jo vetëm që është titullar i padiskutueshëm, por madje trajneri herë-herë i ka besuar edhe shiritin e kapitenit, një vlerësim i lartë dhe plotësisht i merituar, teksa është lënë pas sezoni i kaluar, kur mbrojtësi 27-vjeçar pati dëmtime dhe shpesh humbi ndeshje në Itali.



## Tare: Jemi një komb, Hasin e Canën i kam konsideruar si vëllezër

**TIRANË, 17 SHTATOR** - Igli Tare ka dhënë mesazhe të fuqishme bashkimi mes shqiptarëve, duke u shprehur kategorikisht kundër dhe kritik ndaj ndarjeve dhe përçarjeve mes shqiptarëve. I ftuar në emisionin "E Diell" në "Top Channel", legjenda e futbollit shqiptar e dha mendimin dhe mesazhin e tij për shqiptarët, mbi të gjitha pas episodeve të fundit, ku pati debat mes shqiptarëve të Kosovës me ata të Shqipërisë. "Ne jemi një komb. Nuk i kam konsideruar kurrë Besnik Hasin ose Lorik Canën, që kanë ardhur të parët për ta dhënë kontributin e tyre në Kombëtaren shqiptare, si kosovarë, por si vëllezërit e mi. Kështu që, do të ishte diçka shumë e ulët të jemi dëshmitarë të këtyre episodeve. Do ta jepja një mesazh: nuk ekziston Kosova mënjane, larg nga Shqipëria", ka



deklaruar fillimisht ish-futbollisti i Lazios. "Ekziston shqiptaria dhe ne të gjithë jemi dhe e prezantojmë një komb. Kështu që, nëse është Dua Lipa apo Lorik Cana, apo është dikush tjetër si Ismail Kadare apo si Nënë Tereza, apo të gjithë ata njerëz që e kanë

dhënë kontributin... janë munduar të na ndanin gjithë jetën, në historinë tonë, por ka ardhur momenti që të jemi të gjithë bashkë. Do të ishte një mesazh i bukur për të gjithë kombin tonë", ka përfunduar ish-përfaqësuesi shqiptar.

## Tonali flet për varësinë ndaj lojërave të fatit: Isha një person tjetër

**NEWCASTLE, 17 SHTATOR** - Repreruesi italian Sandro Tonali ka dhënë një intervistë të gjatë për mediet britanike, duke folur për varësinë që kishte ndaj lojërave të fatit dhe dënimin prej dhjetë muajsh që pasoi pasi u shpall fajtor për përfshirje në bastvënie të paligjshme. Tonali mori një dënim prej dhjetë muajsh nga FIGC tetorin e kaluar dhe u dënua me 20 mijë euro si dhe u urdhërua që të marrë pjesë në evente të ndryshme për t'i paralajmëruar të tjerët për rreziket e lojërave të fatit. Ai së fundmi shënoi rikthimin e tij në futboll me Newcastle, duke luajtur titullar në sfidën ndaj Nottingham Forest në Kupë si dhe duke u futur nga banka në dy fitoret e fundit në Ligën Premierë ndaj Tottenhamit dhe Wolvesit. "Para këtij gabimi unë kisha dy jetë, sepse isha shumë i mbyllur në vetvete dhe kurrë nuk bisedoja me njerëzit, as në qendrën stërvitore dhe me stafin. Tani është plotësisht



ndryshe. Çdo ditë është më ndryshe, veçanërisht me stafin dhe bashkëlojtarët e mi, sepse është normale të bisedosh çdo ditë, është normale të kesh një marrëdhënie", ka thënë Tonali. "Kur erdha në qendrën stërvitore unë isha i njëjti person tani, me trajnerin, me stafin, me bashkëlojtarët e mi. Para këtyre 10 muajve, para vitit të kaluar, nuk e

di, por është pak më ndryshe sepse isha një person tjetër. Unë isha dy njerëz të ndryshëm në jetën time dhe në futboll. Dhe tani unë jam vetëm një person, vetëm një", ka deklaruar Tonali. "Më munguan 10 muajt e fundit, më mungoi futbollin, më mungoi stadiumi, të gjitha emocionet në fushë, por tani jam rikthyer. Mendoj, më të vërtetë, mirë", ka përfunduar Tonali.

### SHKURT

#### Asani dhuron spektakël në Ligën e Kampionëve

Jasir Asani ka dhuruar spektakël në Ligën e Kampionëve të Azisë me një "triple" golash. Lojtarit shqiptar i mjaftuan vetëm dy minuta lojë për ta gjetur golin e parë. Në Ligën e Kampionëve të Azisë, në takimin kundër Yokohama Marinos, skuadër japoneze, Asani realizoi golin e parë të ndeshjes me një goditje siç ai di nga distanca me të majtën. Goli i Asanit la pa fjalë edhe ekipin e tij Gwangju që reagoi menjëherë me anë të një statusi në rrjetet sociale: "Pa fjalë", shkruan klubi korean. Në fillimin e pjesës së dytë ai realizoi golin e dytë me një tjetër goditje spektakolare me të majtën. Në minutën e 69 sulmuesi i Shqipërisë ka dhënë asistim për shokun e skuadrës Mikeltadze i cili e ktheu në gol. Në fundin e ndeshjes Jasiri realizoi golin e tretë duke e mbyllur ndeshjen me fitoren 7-3.

#### Kapiteni i PSG-së: Synojmë trofeun

Mbrojtësi dhe kapiteni i PSG-së, Marquinho, foli në konferencë për shtyp në prag të ndeshjes në Ligën e Kampionëve ndaj Gironas. "Favoritet e mëdhenj janë ata që tashmë kanë fituar. Vitin e kaluar ne përfunduan në top katërshe. Ne gjithmonë duam të shkojmë më tej, është fillimi i një sezoni të ri dhe konkurrenca do të jetë e madhe. Ne duhet të përparojmë lojë pas loje dhe të shikojmë ku jemi. Girona? Do të jetë një ndeshje shumë e vështirë", ka thënë Marquinho.

#### Joshua: Kam kaluar shumë dhimbje

Anthony Joshua thotë se ai ka "kaluar shumë dhimbje" gjatë dy viteve të fundit, teksa kërkon të bëhet tri herë kampion bote kundër kolegut britanik Daniel Dubois, të shtunën. 34-vjeçari do të përballë me mbajtësin e rripit të IBF-së, Dubois, 27-vjeçar, para 96 000 tifozëve në stadiumin "Wembley". Joshua ka punuar në rrugën e tij për t'u kthyer në pozicionin e sfiduesit, pasi humbi ndaj Oleksandr Usyk në gusht të vitit 2022. "Kam punuar shumë dhe kam kaluar shumë dhimbje. Kam punuar shumë për t'u përmirësuar. Shpresojmë që ato përvoja të mos ndodhin më sepse, siç e patë atë natë, nuk më pëlqen të humbas", ka thënë Joshua për "BBC Sport".

#### Rodri: Do të ishte ëndërr ta fitoja 'Topin e Artë'

Ylli i Manchester Cityt, Rodri, ka thënë se do të ishte një ëndërr për të që ta fitonte "Topin e Artë". Ceremonia e ndarjes së çmimit më të madh individual, Topi i Artë 2024, do të mbahet më 28 tetor në Paris. Një nga favoritët kryesor për ta fituar çmimin është edhe Rodri, i cili e ka cilësuar ëndërr triumfin në këtë garë pas fitimit të Ligës Premierë dhe Kampionatit Evropian këtë vit. "Do të ishte një ëndërr", ka thënë fillimisht mesfushori spanjoll i cili është ndër favoritët për çmimin e madh individual. "Jam shumë i lumtur për gjithçka që më ndodh në vitet e fundit. Fitimi i trofeve me Cityn dhe fitimi i Evropianit me vendin tim është vetëm një ëndërr. Është pasojë e punës së palodhur, konsistencës, të mos dorëzohen kurrë", ka deklaruar Rodri. Përveç Rodrit, në garën e ngushtë për ta fituar "Topin e Artë" janë edhe Vinicius Junior, Dani Carvajal dhe Jude Bellingham.

## Guardiola: Tani Interi është edhe më i fortë

15 muaj pas finales në Stamboll, Manchester City dhe Interi rikthehen për t'u përballur në javën e parë të Ligës së re të Kampionëve. "Qytetarët" triumfuan dy sezone më parë, por Pep

Guardiola beson se tashmë zikaltrit janë dhe më të fortë. "Unë ju thashë në atë kohë sa të fortë ishin zikaltrit. Tani më besoni. Dje e pashë përsëri finalen e Stambollit për herë të parë. Më kujtohet se ishte një

ndeshje shumë e ngushtë, me Interin që pati dy raste shumë të qarta. Ne patëm vetëm një rast me Foden, pas golit të Rodrit, por tani Interi është edhe më i fortë në Itali. Calhanoglu, Acerbi, sidomos

Barella... është një ekip i kompletuar, i cili mund ta fitojë kampionatin italian. Ka ruajtur strukturën e finales së Ligës së Kampionëve në Stamboll", ka thënë Guardiola. "Formati i ri? Duhet ta fitojmë

ndeshjen e parë dhe më pas ato në vijim. Le të shohim se çfarë do të ndodhë. Duhet ta fillojmë mirë në shtëpi. Do të përpiqemi ta nisim mbarë edicionin e ri", u shpreh Guardiola.









KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE

"Ambienti" SH.A PEJË  
NR 1499  
DATA 17.09.24

Kompania Regionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë  
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas neni 8,dhe në bazë të Udhzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanis Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh.A .Pejë me datë 18.09.2024, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës :

## KONKURS

## Pozita : Menaxher i Operatives 1 Pozit

Vendi punës : Pejë

Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.

Koefficienti i pagës 3.6

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Organizon mbikëqyr punën dhe gjendjen ne Deponin Sanitare , pranon dhe japë sygjerrime dhe rekomandime nga përgjegjësi i Deponisë ne lidhje me menyren e trajtimit te Deponisë duke respektuar Standardet e kërkuara , mbanë evidencë per sasinë e mbeturinave te deponuara , shpenzimet e karburanteve dhe sasin e transportuar veq e veq pe secilin automjet si dhe bën analiza mujore per arësyeshmërinë e ketyrë shpenzimeve;
- Mbikëqyr dhe i kordinon punët e Punëtorisë , te cilat kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e Automjeteve , si dhe kontrollon dhe miraton furnizimet-shpenzimet e krijuara ne punëtori duke kërkuar raporte ditore-mujore nga Kryepunëtori i punëtorisë;
- Me ndihmen e Kryepunëtorëve konkret si dhe rekomandimet e Organit përgjegjes të K.K. Pejë harton Planin Operativ ditor javor dhe mujor per kryerjen e shërbimit ne grumbullimin e mbeturinave , përzgjedh ekipet e caktuara te cilat do ta respektojnë orarin dhe itinererin e kryerjes se shërbimeve , sigurohet se te gjitha shërbimet ne lidhje me mbeturinat te jenë sa ma kualitative ;
- Kordinon punët ne Larjet dhe fshirjet e rrugëve dhe trotuareve te Qytetit te Pejës , te gjitha keto i bën ne bashkëpunim me Kryepunëtorin dhe mbikëqyrësin e caktuar nga K.K. Pejë , ne bashkëpunim me Kryepunëtorin pregaditë Raporte mujore per punët e kryera.
- Te gjitha keto punë i kryen bashkë me Ndihmësin-Asistentin e Njllsë.
- Për punën e tij i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv .

## a. Kushtet e përgjithshme :

- Një CV te detajuar
- Çertifikata që kandidati nuk është nen hetime
- Letër motivimi
- Kopja e leternjoftimit
- Çertiata mbi gjendjen shendetsore

## b. Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)

- Diplomë Universitare ne fushën e makinerisë
- Shkathësi komunikuese dhe aftësi organizative të punës
- Njohuri për punë në kompjuter (MS Word, Excel etj.)
- Njohja e gjuhëve të huaja do të jetë përparësi
- Përvoja e punës së paku 3 (tri) vite e deshmuar

## Pozita : 2 Puntor fizik në mbledhjen e hedhurinave

Vendi punës : Pejë

Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.

Koefficienti i pagës 2

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e hedhurinave.
- Mbledh hedhurinat dhe bënë zbrazjen e Kontenjerve dhe mjeteve tjera për hedhurina apo çesese nga shfrytëzuesit e shërbimeve në sektorin privat dhe shtetëror.
- Pas zbrazjes së Kontenjerve dhe mjeteve tjera, është i obliguar t'i kthej ato në vende të caktuara dhe për to të ketë kujdesë.
- Është përgjegjës për kryerjen e punëve në mënyrë efikase dhe kualitative, për sjellje korrekte me qytetarët-shfrytëzuesit e shërbimeve.
- Është i obliguar te mbaj uniformen e ndermarrjes dhe pajisjet e tjera te punës.
- Kryen pune bazuar ne kontraten e punes por edhe punë tjera me urdhëres të Shoferit dhe Kryepunëtorit.
- Për mos respektimin e pikave te lartecekura i përgjigjet drjtëpërdrejtë, Kryeshefit Ekzekutiv.

## a.Kushtet e përgjithshme :

- Një CV te detajuar
- Çertifikata që kandidati nuk është nen hetime
- Letër motivimi
- Kopja e leternjoftimit
- Çertiata mbi gjendjen shendetsore ( kërkohet pas pranimit në punë )

## b.Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)

- Të ketë njohuri për shkrim dhe lexim përparësi shkollimi fillore
- Aftësi fizike dhe psikike te deshmuar
- Përparësi përvojë pune e deshmuar.
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;

## Pozita : 1 Puntor fizik në mbledhjen e hedhurinave

Vendi punës : Istog

Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.

Koefficienti i pagës 2

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e hedhurinave.

- Mbledh hedhurinat dhe bënë zbrazjen e Kontenjerve dhe mjeteve tjera për hedhurina apo çesese nga shfrytëzuesit e shërbimeve në sektorin privat dhe shtetëror.
- Pas zbrazjes së Kontenjerve dhe mjeteve tjera, është i obliguar t'i kthej ato në vende të caktuara dhe për to të ketë kujdesë.
- Është përgjegjës për kryerjen e punëve në mënyrë efikase dhe kualitative, për sjellje korrekte me qytetarët-shfrytëzuesit e shërbimeve.
- Është i obliguar te mbaj uniformen e ndermarrjes dhe pajisjet e tjera te punës.
- Kryen pune bazuar ne kontraten e punes por edhe punë tjera me urdhëres të Shoferit dhe Kryepunëtorit.
- Për mos respektimin e pikave te lartecekura i përgjigjet drjtëpërdrejtë, Kryeshefit Ekzekutiv.

## a.Kushtet e përgjithshme :

- Një CV te detajuar
- Çertifikata që kandidati nuk është nen hetime
- Letër motivimi
- Kopja e leternjoftimit
- Çertiata mbi gjendjen shendetsore ( kërkohet pas pranimit në punë )

## b.Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)

- Të ketë njohuri për shkrim dhe lexim përparësi shkollimi fillore
- Aftësi fizike dhe psikike te deshmuar
- Përparësi përvojë pune e deshmuar.
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;

Mënyra e Aplikimit:Dokumentacioni duhet të dërgohen ne e-mailit [krmambientikonkurset@gmail.com](mailto:krmambientikonkurset@gmail.com)

Data e për aplikim është nga 18.09.2024 deri me 03.10.2024 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet origjinale mund të kërkoen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



**MEKA**  
HALAL FOOD

**TRADITË QË NGA**

**1992**









## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

